



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI

Nr. 3781 Prot.

Tiranë, më 3.12.2021

**AUTORIZIM**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 149/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 9, të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 419, datë 24.11.2021, “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit nga Presidenti i Republikës për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2022”, si dhe Vendimit nr. 404 datë 25.11.2019, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””,

**AUTORIZOJ:**

1. Kryerjen e drejtimit dhe moderimit të procedurës së hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (2022) në datën 3 dhjetor 2021, ora 11:00, dhe shpalljen e rezultatit nga zoti **Bledar Dervishaj**, Këshilltar i Presidentit të Republikës për Çështjet Ligjore.
2. Tërheqjen rastësore të goglave për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nga anëtarë të Sekretariatit Teknik dhe/ose nga përfaqësues të institucioneve apo misioneve të ekspertizës së huaj të cilët janë ftuar për të qënë të pranishëm në procedurën e hedhjes së shortit përkatësisht, sipas ftesës së drejtuesit e moderuesit të procedurës.
3. Personi i autorizuar si më sipër të ndjekë rregullat e detajuara për organizimin e procedurës së hedhjes së shortit, të përcaktuara në Vendimin nr. 404 datë 25.11.2019, “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”” dhe në këtë autorizim.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

